



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiut për Administratë

Prishtinë, 10 maj 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Administratë



10 maj 2011 „Bujana” në Gjilan

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Administratë organizoi takimin e parë për këtë vit të këtij Kolegjiut me 10 maj 2011 (e martë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Bujana“ në Gjiilan.

Rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia ishte si vijon:

- Miratimi i Rregullores së Kolegjiut,
- Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut (nga radhët e komunitetit serb),
- Identifikimi i pjesëmarrësve potencial në grupet punuese në procesin legjislativ,
- Vlefshmëria e dokumenteve,
- Shkëmbimi i përvojave në fushën e zyrave pritëse,

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Administratës nga Komunitatet e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Administratë z. Xhemë Binaku.

PËRMBLEDHJE

z. Xhemë Binaku, Kryesues i Kolegjiut – në fjalën hyrëse shprehu mirënjohje AKK-së për organizimin e këtij takimi dhe po ashtu falënderoj të gjithë për pjesëmarrje në këtë takim, ku pranoj se kanë pasur takime të pakta por në të ardhmen do të ketë një bashkëpunim më të mirë për punën e përbashkët. Kryesuesi prezantoi rendin e ditës, dhe pas miratimit të rendit të ditës në mënyrë unanime vazhdoi me pikën e parë:

➤ **Miratimi i Rregullores së Kolegjiut**

z. Enver Ajvazi, Drejtor i Administratës - Kamenicë – në fjalën e tij theksoj se drejtorët janë promotor të punës së administratës, andaj këto takime duhet të jenë të rregullta dhe më aktive në pjesëmarrje dhe iniciativa. Sa i përket rregullores, ajo do duhej të sqarohet se kur do të mbahen mbledhjet dhe afati i tyre.

z. Božidar Perić, Drejtor i Administratës – Partesh - sugjeroj se rregullorja është e mirë, mirëpo tek kuorumi të precizohet edhe numri i drejtorëve, si dhe se sa do të jetë numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kolegjiut. Përndryshe rregullorja në esencë është e mirë.

Kryesuesi – sqaroi se nuk është përcaktuar numri i përgjithshëm i anëtarëve për shkakun e themelimit të komunave të reja dhe atyre në veriun e vendit të cilat nuk kanë pranuar të bashkohen në këtë organizëm.

Ertan Munoglu, Menaxher i Programit në AKK – ndërhyri duke treguar se Asociacioni i Komunave të Kosovës ka 34 komuna anëtare dhe se ato 3 komuna të veriut nuk i janë bashkangjitur këtij organizmi me vullnet të lirë. Pjesëmarrja e secilës komunë në AKK është në baza vullnetare.

z. Reshat Nurboja, Drejtor i Administratës - Pejë – duke kundërshtuar parafolësit ceku se të gjitha komunitetet janë pjesë e pandashme e Republikës së Kosovës, andaj ne duhet ti përfshijmë ato dhe nëse

ata nuk marrin pjesë në punën tonë. Duhet të respektojmë tërësinë territoriale të Kosovës dhe ne nuk duhet të përjashtojmë asnjë palë në këtë proces sepse është në interesin tonë të punojmë për interes të gjitha komunave të Kosovës.

z. Halim Halimi, Drejtor i Administratës – Prishtinë - në vazhdim të debatit theksoj se jemi një organ profesional dhe nuk duhet të merremi me çështje politike, sepse ne nuk mund ti kyçim ata pa dëshirën e tyre. Nuk e kemi atë obligim por shohim interesin tonë në AKK se nuk mund të mbesim peng i tyre në këtë proces. Duhet të themi se kemi një rregullore të mirë por me disa lëshime teknike të cilat nuk kanë ndonjë peshë apo problem serioz.

z. Ertan Munoglu – sqaroj se puna e anëtarëve është një vullnet i lirë i komunave që të jenë pjesëmarrëse në Asociacion, sepse në kuadër të mundësive juridike kemi një status të OJQ-së për AKK-në, ku përfaqësimi bëhet në baza vullnetare. Çdo anëtarë i AKK-së ka të drejta dhe obligime të barabarta, dhe meqë këto komuna nuk kanë pranuar të jenë pjesë e AKK-së (përkundër ftesës sonë të hapur dhe të përhershme) ato nuk mund të janë pjesë e jona. Kolegjiumit e AKK-së janë të natyrës profesionale, e jo politike, dhe prandaj nuk ia vlen të diskutojmë për çështje politike këtu. Për më tepër, çdo vendim i Kolegjiumeve duhet të jetë në përputhje me statutin, rregulloret e brendshme dhe qëndrimet e Bordit të AKK, dhe nëse ju vendosni ndryshe atëherë Bordi mund të zhvlerësoj atë vendim.

z. Reshat Nurboja, Drejtor i Administratës - Pejë – në vazhdim të diskutimi nguli këmbë se duhet të jetë AKK-ja ajo që duhet të përfshijë të gjithë në një sistem unik, dhe nëse Asociacioni është një OJQ. atëherë ekziston mundësia në mospjesëmarrje të mëtutjeshme në këtë Kolegjium.

z. Arben Dubova – Gjiilan – përkrahi mendimin se AKK duhet të përfshijë të gjitha komunat e Kosovës.

z. Avni Nebiu, Drejtor i Administratës – Dragash - në vazhdim të debatit ceku se duhet të përfshihen të gjitha sugjerimet, ndërsa sa i përket statusit ai përcaktohet me statut se a është apo nuk është një OJQ. Me nënshkrimin tonë ne kemi marrë edhe disa obligime kundrejt këtij Asociacioni, nëse janë vetë Kryetarët e komunave nënshkruese të këtij procesi edhe detyrimisht do të jemi në zbatim të atyre obligimeve.

Edhe z. Ilirian Bytyçi – Suharekë, dhe z. Halim Halimi – Prishtinë, theksuan se AKK është një organizatë anëtarësia në të cilën është në baza vullnetare.

Kryesuesi - çfarëdo përfundimi apo rekomandimi që nxjerr AKK-ja nuk janë të obligueshëm për anëtarët të cilët nuk janë pjesëmarrës në Asociacion të Komunave të Kosovës andaj edhe rekomandoj të shterim këtë pikë të debatit.

z. Rujdi Kruezi – Mamushë – kërkoi që Rregullorja dhe çdo dokument tjetër të përkthehet edhe në turqisht. Nëse nuk keni mundësi për këtë, na dërgoni neve dhe ne do ta përkthejmë.

z. Islam Revuq – Podujevë – theksoi se ky është Kolegjium i Drejtorëve komunal për administratë, prandaj të njëjtin titull do duhej ta kishte edhe rregullorja.

Në pajtim me të gjithë pjesëmarrësit u votua dhe u vendos në mënyrë unanime të miratohet rregullorja me ndryshime përkatëse ku edhe do tu përcillen të gjithë pjesëmarrësve.

z. Lulzim Kadriu, Drejtor i Administratës – Skenderaj – potencoi se rregullorja nuk parasheh se si do të zgjidhet Kryesia, prandaj kjo duhet të përfshihet gjithsesi.

Në vazhdim poashtu u rekomandua që nga rregullorja të fshihet teksti në pikën 2.2 i cili i referohet vendimit të Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi shpjegoi se zgjedhja e Kryesisë deri tani ka qenë me shumicë të thjeshtë ndërsa votimi ka qenë me vota të hapura, dhe në pajtim me shumicën u vendos që kjo të mbetet e njëjtë. Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë do të futet në pikën 2.4 të rregullores. Pika 2.2 do të revidohet në përputhje me diskutimet. Ndërsa pas rekomandimeve pika 2.6 do të zhvendoset tek neni 3, për të krijuar konsistencë në përgatitjen dhe thirrjen e takimeve të Kolegjiut.

➤ **Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut (nga radhët e komunitetit serb)**

Në vazhdim kryesuesi sugjeroj të bëhet plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut nga anëtarët e komunitetit serb. Ai theksoj se do të ishte mirë të zëvendësohej me një anëtare të re nga komuniteti serb duke ditur së anëtarja e kryesisë ka qenë e gjinisë femërore të vazhdohet me të njëjtin parim. Pas një diskutimi të shkurtë në parim u vendos që në takimet e ardhshme si anëtare e re në Kryesinë e Kolegjiut për Administratë të përfaqësohet Mary Tomic - Drejtoreshë e Administratës në Komunën e Kllokotit.

➤ **Identifikimi i pjesëmarrësve potencial në grupet punuese në procesin legjislativ**

Kryesuesi – kemi pasur takim me zyrtarët ligjor të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të linjës, ku është diskutuar për pjesëmarrje në grupet punuese të procesit legjislativ, të cilat janë në interes të komunave të Kosovës. Në këto takime është kërkuar të japim kontributin tonë në këto grupe si palë dhe me këtë rast edhe duhet të bëjmë identifikimin e personave të përshtatshëm të cilët do të marrin pjesë në grupet punuese legjislative.

z. Ertan Munoglu – u bëri me dije të pranishmëve se zyrtarja ligjore e AKK-së, merr pjesë në mënyrë të rregullt në grupet punuese legjislative, por meqë është vetëm një person ajo nuk mund të mbulojë të gjithë veprimtarinë legjislative, andaj edhe është vendosur se do të ishte mirë që të jeni edhe ju përfaqësues direkt në këto grupe punuese duke ditur se është në interesin tuaj. Me rëndësi është të kemi emrat e personave të cilët janë të gatshëm të marrin pjesë në këtë proces, të jenë aktiv dhe të informohen për procesin legjislativ nga dora e parë. Për më tepër këta përfaqësues do duhej pastaj të raportojnë në Kolegjiut për ecurinë e ligjeve në të cilat marrin pjesë.

z. Avni Nebiu, Drejtor i Administratës – Dragash - sugjeroj se duhet të precizohet a do të jetë një grup apo një person si anëtarë potencial në këto grupe punuese legjislative.

Kryesuesi - është mirë të jemi pjesëmarrës të drejtpërdrejt në këto procese, ku mund të jemi aktiv në grupet punuese rreth projektligjeve të mundshme që do të jenë në interes të komunave, dhe ku do të shprehim vërejtjet tona për ligjet para se ato të aprovohen në Kuvendin e Kosovës.

Pas një diskutimi të shkurtë palët shprehën interesin për pjesëmarrje në grupet punuese dhe u vendos që të jenë këta personat të cilët do ta marrin pjesë në grupet punuese:

1. Ilirian Bytyçi, Suharekë- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-28 për procedurën administrative,
2. Reshat Nurboja, Pejë - Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
3. Arben Dubova, Gjilan- Projektligji për pagat e funksionarëve publikë,
4. Ekrem Reçica, Shtime- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-241 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës,
5. Xhemë Binaku, Drenas- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
6. Vanja Trajković, Ranilug- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/2 për barazi gjinore,
7. Abdullah Bejtullahu, Mitrovicë- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë,
8. Rujdi Krüezi, Mamushë- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-31 për lirinë fetare,
9. Vesel Zhinipotoku, Ferizaj- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/7 për lëndën Arkivore dhe Arkivat,
10. Enver Ajvazi, Kamenicë- Projektligji për punën në zyrë,
11. Lenhard Hamza, Rahovec- Projektligji për qeverisje elektronike.

➤ **Vlefshmëria e dokumenteve**

Kryesuesi në këtë pikë informoj të pranishmit se MPB, se me Rregulloren Nr. 2008/25 është shpallur dhe ka hyrë në fuqi Ligji Mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Regjistrat e Gjendjes Civile. Në këtë ligj, përveç të tjerave, janë përcaktuar edhe afatet e vlefshmërisë së certifikatave të cilat qytetarët mund t'i përdorin për nevojat e tyre në raport me institucionet e ndryshme. Me nenin 8 të këtij ligji është përcaktuar se: "**Certifikatat e lindjes, martesës dhe të vdekjes janë të pa afatizuara, përveç rasteve të lidhjes së martesës**, nënshkruhen nga zyrtari i gjendjes civile dhe vulojnë me vulë përkatëse". Përkundër kësaj institucionet e ndryshme shpallin konkurse me anë të të cilave kërkojnë certifikata jo më të vjetra se 6 muaj 9si p.sh. konkursi rishtazi i shpallur nga FSK). Andaj të gjithë ju duhet ti njoftoni qytetarët rreth dokumenteve të cilat janë të pa afatizuara tash e tutje.

z. Arben Dubova, Drejtor i Administratës – Gjilan - pajtohem me këtë pikë sepse kemi hasur në probleme të qytetarëve me ambasadat të cilët kërkojnë origjinalin dhe pastaj qytetarët detyrohen të nxjerrin dokumentin e ri. Në bazën e të dhënave tona qytetarët kërkojnë dokumentet e reja në mënyrë të vazhdueshme në bazë të arsyeve specifike të tyre.

z. Halim Halimi – Prishtinë - jemi ballafaquar me probleme të tilla, sidomos gjatë fundit të vitit shkollor kur bëhet regjistrimi i nxënësve në fakultete, ku edhe kemi fluksin më të madh të kërkesave. Andaj

duhet të apelojmë që të bëhet respektimi i kësaj rregullore nga ana e organeve vendore, e pastaj edhe atyre ndërkombëtare. Duhet të ketë një sqarim për të gjitha palët në këtë proces rreth kësaj rregullore.

z. Avni Nebiu, Drejtor i Administratës – Dragash - duhet të kemi të qartë se çdo palë mund të kërkojë dokumentin e ri, sepse nuk ka një kriter i cili sanksionon këtë, mirëpo duhet tu bëjmë me dije të gjitha palëve se kjo rregullore është në fuqi për vlefshmërinë e dokumentacionit të tyre, dhe të informohen ministritë dhe të gjitha organet relevante në lehtësimin e punëve të qytetarëve.

z. Nevruz Krasniqi, Drejtor i Administratës – Junik – problemi qëndron edhe në faktin se vërtetimi i origjinalit të certifikatave është më i shtrenjtë sesa nxjerrja e certifikatës së re, prandaj edhe qytetarët preferojnë të aplikojnë në komunë për dokumente të reja.

Kryesuesi duke përmbyllur këtë pikë theksoi se Kolegjiumi do të dërgoj një shkresë tek të gjitha institucionet për t'i informuar rreth vlefshmërisë së dokumenteve. Ndërsa i mbetet secilin nga ne të informojmë Drejtorët komunal për arsim që gjatë procesit të regjistrimit të nxënësve, shkollat të mos kërkojnë certifikata të reja.

➤ **Shkëmbimi i përvojave në fushën e zyrave pritëse**

z. Dubova – shprehu kënaqësinë e tij, të prezantojë një rast të mirë sikurse është ai i funksionimit të zyrës pritëse për shërbim të qytetarëve. Mund të debatojmë rreth kësaj çështjeje dhe të jepni sugjerimet tuaja për ndonjë përmirësim të mundshëm në të ardhmen. Pastaj i dha fjalën znj. Fatushe Halitit për prezantimin e radhës e cila në pika të shkurta shpjegoi punën dhe funksionimin e Qendrës për Shërbime të Qytetarëve- funksionin dhe veprimtarinë e saj (shih prezantimin e bashkangjitur).

z. Nurboja – në paraqitjen e tij tha se në Pejë është e njëjta procedurë sikurse në Gjiilan. Më e rëndësishmja është se të gjitha shërbimet për qytetarët kryhen në një vend, dhe është bërë digjitalizimi i këtyre aktiviteteve e shërbimeve - qytetarët mund ti parashirojnë kërkesat në mënyrë elektronike, dhe po ashtu të marrin përgjigjet në të njëjtën mënyrë.

➤ **Konkluzionet**

1. U plotësua Kryesia e Kolegjiumit me Mary Tomic - Drejtoreshë e Administratës në Komunën e Kllokotit
2. Anëtarët e Kolegjiumit të lartcekur do të marrin pjesë në grupet punuese qeveritare gjatë procesit legjislativ, dhe do të njoftojnë Kolegjiumin për ecurinë e këtij procesi.
3. Të dërgohet kërkesë tek të gjitha ministritë dhe drejtoritë komunale për arsim, si dhe ambasadave në Kosovë, që të respektojnë ligjin sa i përket vlefshmërisë së dokumenteve të gjendjes civile.